



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 6 të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë nr 4 e datës 1 shtator 2006 , si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

## **VENDIM PËR THEMELIMIN E ORGANIT TË KUJDESTARISË**

### **Neni 1 Themelimi**

Me këtë vendim themelohet Organi i Kujdestarisë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale në Lipjan .

### **Neni 2 Funksioni**

Organi i Kujdestarisë është organ administrativ komunal kompetent për çështje sociale dhe përbëhet nga ekspertë me përvojë profesionale në fushën e mbrojtjes sociale, psikologjisë, drejtësisë, pedagogjisë apo fushave të ngjashme me qëllim të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave në mbrojtjen dhe ndihmën familjare, në përputhje me Ligjin për Familjen të Republikës së Kosovës.

### **Neni 3 Përbërja**

Organi i Kujdestarisë përbëhet nga këta anëtarë:

1. Fjolla Ibrahim - Starabaja - Kryesuese
2. Hyrije Qerkini- Zëvendës - kryesuese
3. Suzana Mehmeti-Blakqori -anëtare
4. Sevdije Jashanica- anëtare
5. Rinesa Luma – anëtare
6. Jeton Dragaqina - anëtar
7. anëtar rezervë i caktuar ad.hoc

2. Në rast të mungesës së kryesueses së Organit të Kujdestarisë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë barten te zëvendës-kryesuesja e cekur në numrin rendor 2.

3. Në rast të mungesës apo konfliktit të interesit të zëvendës-kryesueses apo anëtarëve të tjerë të organit të kujdestarisë Drejtori/ja e QPS-së me akt të veçantë cakton anëtarin rezervë ad.hoc (numri rendor 7) i cili apo e cila merr kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarit të rregullt vetëm për rastin për të cilin është caktuar me akt të veçantë të Drejtorit të QPS-së.

#### **Neni 4** **Kompetencat**

Organi i Kujdestarisë ushtron detyrat dhe kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Familjen dhe legjislacionin përkatës në fuqi, përfshirë:

- mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve;
- kujdesin për personat pa përkujdesje prindërore;
- mbikëqyrjen e ushtrimit të kujdestarisë;
- dhënien e mendimeve profesionale për gjykatat dhe institucionet tjera kompetente;
- ndërmarrjen e masave të tjera të parapara me ligj.

#### **Neni 5** **Zbatimi**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Qendra për Punë Sociale në Lipjan

#### **Neni 6** **Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Nr. 15-112/02-15249  
Lipjan, më 31.03.2026

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Daut Azemi**



*Daut Azemi*